

UDHËZIM
Nr. 38, datë 19.10.2020

**PËR FALJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE ME KARAKTER NDËSHKUES, TË
VENDOSURA GJATË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19, SI DHE NDAJ FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSITË
NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4, të nenit 2, të aktit normativ nr. 31, datë 7.10.2020 “Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore”,

UDHËZOJ:

1. Kthimi i shumës së detyrimit të falur, por të paguar për masat administrative me gjobë, merret nga llogaria ekonomike në të cilën është arkëtuar në sistemin informatik financiar të qeverisë (arkëtim i konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë dhe struktura përgjegjëse e institucionit përkatës në emër të së cilit është paguar gjoba).

2. Përfituesit (individë dhe subjekte) duhet të dërgojnë pranë strukturës përgjegjëse të institucionit që ka vendosur masën administrative në favor të të cilit është bërë pagesa e gjobës (shkurt institucioni) informacionin lidhur, me:

- a) emër mbiemër i individit/emërtim i subjektit;
- b) ID kartë identiteti/NIPT;
- c) IBAN;
- d) emrin e bankës pranë së cilës kanë llogarinë personale/llogarinë e subjektit;
- e) vërtetimin bankar që llogaria bankare ku do të arkëtohet kthimi i gjobës është aktive;
- f) subjektet paraqesin edhe vërtetimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

3. Struktura përgjegjëse e institucionit harton urdhërpagesën për vlerat totale për çdo bankë të nivelit të dytë ku është kryer arkëtimi i gjobës, duke i bashkëlidhur listën emërore të përfituesve për bankën respektive. Urdhërpagesa për kthimin e gjobave subjekteve shoqërohet me vërtetimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe vërtetimin bankar.

4. Pas konfirmimit nga strukturat përgjegjëse për Thesarin në degë, strukturat përgjegjëse të institucionit dërgojnë paralelisht listën emërore të individëve përfitues në bankën respektive të nivelit të dytë.

5. Institucionet me vetëfinancim që operojnë me llogari bankare të veçantë nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë”, në Bankën e Shqipërisë, zbatojnë procedurat e tyre të miratuara nga titullari.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse të institucionit dhe strukturat përgjegjëse për Thesarin në degë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**